



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 66, Datë 12.04.2024

MBI

**HEQJEN E PEZULLIMIT TË VENDOSUR ME VENDIMIN NR. 309, DATË 30.10.2023
“MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
APLIKIMIN E SHOQËRISË “ECO-ELB” SH.A. PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

DHE

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ECO-ELB” SH.A. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2, gërma “a” dhe 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a” dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenin 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 645/4 prot., datë 09.04.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin nr. 309, datë 30.10.2023 “Mbi pezullimin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. për rinovimin e licencës së në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike” dhe rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 309, datë 30.10.2023, vendosi të pezullojë vendimmarrjen për aplikimin e shoqërisë “ECO- ELB” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW, derisa shoqëria të depozitojë në ERE Kontratën e

rinovuar të qirasë me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për përdorimin e impiantit të incenerimit për prodhimin e energjisë elektrike, brenda datës 27.03.2024.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 137/20 prot., datë 31.10.2023 dhe me shkresën nr. 645 prot., datë 16.02.2024, i është kujtuar plotësimi i këtij dokumenti brenda afatit të përcaktuar në vendim.
- Me e-mailin e datës 29.01.2024 dhe shkresën e protokolluar në ERE me nr. 645/3 prot., datë 04.04.2024, shoqëria ka depozituar në ERE Kontratën e Qirasë nr. 1111 prot., datë 28.03.2024, nënshkruar mes Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (në cilësinë e qiradhënësit) dhe shoqërisë “ECO – ELB” sh.a. (në cilësinë e qiramarrësit) me afat nga 28.03.2024 deri më 27.03.2025. Po ashtu, shoqëria ka bërë me dije se turbina nuk ka qenë dhe vazhdon të mos jetë në gjendje pune.
- Me depozitim të kontratës së qirasë si më sipër rezultoi se nuk ekziston më kushti pezullues i vendimit të nr. 309/2023, e në të tilla rrethana vlerësohet të vijohet me heqjen e këtij pezullimi dhe marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW.
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim, njohje dhe heqje të licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por afati i kontratës së qirasë të nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (në cilësinë e qiradhënësit) dhe shoqërisë “ECO – ELB” sh.a. (në cilësinë e qiramarrësit) ka afat vlefshmërie deri më 27.03.2025. Në këto rrethana ERE kushtëzohet nga ky afat përse i përket afatit të vlefshmërisë që do të ketë ky rinovim licence, pra deri më 27.03.2025.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Heqjen e pezullimit të vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë “ECO- ELB” sh.a. të vendosur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 309, datë 30.10.2023.

2. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ECO- ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW, me afat deri më 27.03.2025.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “ECO-ELB” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI